



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.228/22

GJYKATA KOMERCIALE -Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Krenar Berisha dhe Faton Bajrami, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit NTSH “D...” me seli në Kaçanik, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Basri Jupolli avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti Për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.2236/15, të dates 02.03.2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.11.2022, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit NTSH “D...” me seli në Kaçanik, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.2236/15, të dates 02.03.2020, **vërtetohet**.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative - Divizioni Fiskal, A.nr.2236/15, të datës 02.03.2020, është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit NTSH “D...” me seli në Kaçanik. Ndërsa mbetet në fuqi vendimi nr.340/2015, i datës 16.11.2015, i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, “Jupolli & Associates” nga Prishtina, për shkak të: Shkeljes së rregullave të procedurës administrative dhe kontestimore, konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. Me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të anulohet, dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 81.G të Ligjit për

Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, lidhur me nenin 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se e paditura Administrata Tatimore e Kosovës, me vendimin nr.340/2015, të datës 16.11.2015, në pikën I. të dispozitivit e ka refuzuar si të pa bazuar ankesën nr.340/2015 e datës 15.09.2015 e subjektit NTSH "D..." me numër të regjistrimit të biznesit (NRB) 80284039, si dhe numër fiskal (NRF), me pronar z. H.L., me seli të biznesit në Kaçanik-Komuna e Ferizajit, në mbështetje të nenit 136/a të Ligjit Nr. 02/L-28 për Procedurat Administrative, në lidhje me nenin 89 paragrafin 2, të Ligjit Nr. 03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe Njoftim Rivlerësimet e Tatimit Shtesë të caktuara me kontroll, vërtetohen si të bazuara. Në pikën II të dispozitivit të vendimit, është vendosur që procedura e ankesës nuk ndërprejnë sanksionet për mos përmbushje dhe interesin për ndonjë lloj tatimi sipas Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Paditësi i pa kënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, ka ushtruar padi për konflikt administrativ me datën 24.12.2015, me pretendim se i njëjti është i padrejtë dhe i paligjshëm.

Gjykata e shkallës së parë, pas shqyrtimit të padisë së paditësit paraqitur kundër vendimit nr.340/2015, të datës 16.11.2015, të Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor, e duke u bazuar edhe në provat dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilën kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar. Me arsyetim se në këtë çështje administrative drejtë është vërtetuar gjendja faktike, nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Andaj, pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse të njëjtat i ka vlerësuar si të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga ana e organit të paditur. Prandaj, mbi këtë gjendje të fakteve, gjykata vlerëson se vendimi kontestues i ATK-së, është i qartë dhe i kuptueshëm, si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, duke vlerësuar se edhe drejta materiale është zbatuar drejtë.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e pranon edhe kjo gjykatë si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, dhe nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë me rastin e vendosjes dhe nxjerrjes së këtij aktgjykimi ka interpretuar gabimisht dispozitat e legjislacionit tatimor, këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoj, meqë gjykata ka shqyrtuar padinë, fillimisht e ka dërguar padinë përfaqësuesit të paditurës në përgjigje në padi, pastaj ka caktuar seancën e shqyrtimit kryesor, që do të thotë se gjatë vlerësimit gjykata e shkallës së parë, nuk ka bërë shkelje të dispozitave procedurale të LKA-së dhe LPK-së.

Ndërsa sa i përket pretendimeve ankimore për konstatim të gabuar të gjendjes faktike, se gjykata e shkallës së parë në tërësi e ka injoruar ekspertizën financiare e cila konfirmon plotësisht të kundërtën e përmbajtjes së aktgjykimit rreth përmbajtjes së saj. Po ashtu arsytimin i gjykatës se çdo fature duhet ti bashkangjitet pagesa, nuk qëndron sepse ka me mijëra transaksione e fatura të cilat nuk e kanë pagesën për arsye të ndryshme, dhe nëse çdo faturë do ta kishte pagesën mbrapa nuk do të kishte fare konteste të natyrës juridike nëpër gjykata. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pazuar për tu aprovuar ankesa, si dhe janë të pazuar në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Për shkak se sipas dispozitave ligjore nenit 13 paragrafit 7 i Ligjit 03/L-222 me të cilën është paraparë *“të gjithë personat, të cilët kryejnë transaksione, gjatë aktivitetit të tyre ekonomik në lidhje me furnizimin e mallrave apo shërbimeve në mes të personave më të larta se 500.00euro pagesa e transaksionit duhet të bëhet përmes llogarisë bankare.”*, andaj në bazë të kësaj dispozite kërkohet që pagesa e transaksionit të bëhet përmes llogarisë bankare, kështu pagesa e faturës kontestuese me subjektin “...”, nuk është kryer përmes llogarisë bankare siç parashihet në nenin 22 paragrafi 1 dhe 2 i Udhëzimit Administrativ 15/2010. Andaj, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur është bazuar në dispozitat e LKA-së, dhe Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pazuar për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pazuar në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 dhe nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE PRISHTINË
K.DH.SH.II.nr.228/22, me datë 10.11.2022

Kryetare e kolegjit,

Franciska Zhitija Ymeri